

## NJOFTIM PËR SHTYP

### Mbi zbatimimin e rregullave tranzitore të origjinës për lehtësimin e tregtisë me Bashkimin Evropian dhe vendet e CEFTA-së

**Nga data 1 Shtator 2021 Shqipëria është vendi i parë në rajon që filloi të zbatojë rregullat tranzitore të origjinës të Konvenës Pan-Euro-Mesdhetare, si rregulla alternative me BE-në dhe vendet e EFTAs (bazuar në Vendimin 1/2021).**

Këto rregulla të reja do të lehtësojnë dhe zhvillojnë më tej tregtinë e ndërsjellë ndërmjet vendeve pjesëmarrëse në Konventë dhe me të cilat vendi ynë zbaton një marrëveshje të tregtisë së lirë, pasi:

- ✓ *Janë më të thjeshta dhe më fleksibël;*
- ✓ *Lejojnë vazhdimin e zbatimit të kumulimit diagonal;*
- ✓ *Parashikon zbatimimin e kumulimit të plotë të origjinës (me përjashtim të tekstileve );*
- ✓ *Për produktet e tekstit (kapitujt 50-63 të nomenklaturës së mallrave) lejohet kumulim i plotë vetëm bilateral, për shembull BE-Shqipëri.*
- ✓ *Në kuadër të kumulimit të plotë të origjinës, favor i madh i është bërë vendeve të CEFTAs, pasi të gjitha vendet e Ballakanit quhen si një vend. Në lidhje me tekstilet, kjo është mjaft pozitive sepse proceset që mund të kryhen në vende të ndryshme të CEFTAs konsiderohen se janë kryer në një vend dhe më pas mund të eksportohen në vendin tjetër pasi plotësohet rregulli i kumulimit të plotë bilateral;*
- ✓ *Parashikohet rregulli i kthimit të detyrimeve doganore (me përjashtim të tekstileve) duke i bërë produktet e tyre me konkurese. Kjo do të thotë se për materialet jo origjinuese të përdorura për prodhimin e produkteve origjinuese të cilat eksportohen pas regjimit doganor të përpunimit aktiv, nuk paguhet taksa doganore.;*
- ✓ *Rregulli i tolerancës ka ndryshime mjaft pozitive për operatorët, pasi rritet pragu i mundësisë së përdorimit të produkteve jo-origjinuese nga 10% në 15%.*

- ✓ *Ka avantazhe të reja në certifikatat e origjinës, pasi hiqet certifikata EUR MED dhe Deklarata e Origjinës EUR MED duke lehtësuar procedurat si dhe vlefshmëria e provave të origjinës nga 4 muaj bëhet 10 muaj.*

Në lidhje me zbatimin e këtyre rregullave me vendet CEFTA dhe Turqinë, jemi në pritje të mbylljes së procedurave të brendshme të vendeve CEFTA pasi Shqipëria e ka ratifikuar vendimin 1/2021, ndërsa me Turqinë presim të miratohet nga të dyja palët ky vendim.

Administrata doganore mbetet e angazhuar për të lehtësuar tregtinë e ligjshme nëpërmjet procedurave të thjeshtuara, shërbimit korrekt 24/7 në të gjitha degët/pikat doganore dhe digjitalizimit të shërbimeve në funksion të rritjes së eksporteve dhe lehtësimit të importit.